



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

Organ Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) Rruga "MIGJENTI" (ish-Banka e Ljubljanes) Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: +383 38 212 309 e-mail: oshp@rks-gov.net

PSH. nr. 575/22

Paneli Shqyrtues, i emëruar nga Kryetarja e Organi Shqyrtues i Prokurimit Publik (OSHP), në bazë të nenit 105 dhe nenit 106, nenit 117 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës (Ligji Nr. 04/L-042), i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, në përbërje nga Z. Vedat Poterqoi – panelit individual, duke vendosur sipas ankesës së parashtruar nga Operatori Ekonomik OE "Profitech shpk", lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Furnizim me paisje për praktikë profesionale në stomatologji dhe paisje për pastrim në shkollën Hysni Zajmi" me nr. Prokurimit 632-22-8070-1-2-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) - KOMUNA E GJAKOVËS, me datën 14.11.2022 mori këtë:

V E N D I M

I. **REFUZOHET** si e pabazuar ankesa e operatorit ekonomik OE "Profitech shpk", e parashtruar në Organin Shqyrtues të Prokurimit me 24.10.2022 me numër të protokollit 575/2022, për aktivitetin e prokurimit: "Furnizim me paisje për praktikë profesionale në stomatologji dhe paisje për pastrim në shkollën Hysni Zajmi" me nr. Prokurimit 632-22-8070-1-2-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – KOMUNA E GJAKOVËS.

II. **Mbetet në fuqi**, vendimi i AK lidhur me aktivitetin prokurimit, i përshkruar si në paragrafin paraprak të dispozitivit të këtij Vendimi.

III. Në afat prej 10 ditësh, AK duhet ta informoj OSHP për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit, në të kundërtën për mos respektim të vendimit, OSHP mund të ndërmarr masa ndaj AK sikurse parashihet me dispozitat e nenit 131 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës.

IV. Me qenë se ankesa e për OE "Profitech shpk", refuzohet si e pa bazuar, i bëhet konfiskimi i depozitës dhe mjetet kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

A r s y e t i m

Me 19.09.2022, Autoriteti Kontraktues – Komuna e Gjakovës ka publikuar Njoftimin për dhënie të kontratës lidhur me aktivitetin e prokurimit “Furnizim me paisje për praktikë profesionale në stomatologji dhe paisje për pastrim në shkollën Hysni Zajmi” me nr. Prokurimit 632-22-8070-1-2-1.

Me 24.10.2022 OE “Profitech shpk” ka parashtruar ankesë me (Nr. protokoli: 575/22), kundër njoftimit për dhënie të cituar si më sipër.

Ankesa e OE është ushtruar në pajtim me nenin 109.1, të LPP, sipas të cilit kundër çdo vendimi të marrë nga AK çdo palë e interesuar mund të parashtrojë ankesë pranë OSHP. Meqë OE ka ushtruar po ashtu kërkesë për rishqyrtim, do të thotë se veprimet e të njëjtit i referohen po ashtu dhe nenit 108/A të Ligjit të cituar. Prandaj OSHP konsideron se Ankesa i plotëson kushtet e parapara në kuptim të dispozitave tani më të cituara dhe e njëjta bie nën kompetencat e tij në kuptim të nenit 105, të LPP.

OSHP ka angazhuar ekspertin shqyrtues të prokurimit, që në pajtim me nenin 113 të LPP ta bëjë shqyrtimin fillestar të dosjes dhe pretendimeve ankimore. Eksperti shqyrtues ka dorëzuar raportin e ekspertizës me 28.10.2022, duke i propozuar Panelit Shqyrtues që:

Përgjigje në pretendimin nr. 1

AK – Komuna e Gjakovës ka kërkuar dokumentet e përshtatshmërisë ATK-në dhe Gjykatën të dy OE që kanë qenë të rekomanduar për kontratë për lot 1 dhe Lot 2 me datën 08.09.2022 përmes platformës së e-prokurimit dhe afati i fundit për dorëzim ka qenë me datën 15.09.2022 që ka qenë afat i mjaftueshëm për ti dorëzuar dokumentet ashtu edhe siç kërkohet me LPP-në 5 ditë.

OE i rekomanduar për Lot 1 e ka dorëzuar këto dokumente (ATK dhe Gjykatën) po të njëjtën ditë ndërsa OE Profitech shpk nuk i ka dorëzuar dokumentet në afatin e paraparë nga AK pra deri me datën 15.09.2022 por i ka dorëzuar me datën 20.09.2022 që i bie 5 ditë me vonesë se afati i dhënë nga AK-ja.

OE ankues “Profitech shpk” si arsyetim ka shkruar në pretendimin ankimor se platforma nuk ka punuar këto ditë, mirëpo sipas ekspertit shqyrtues ky arsyetim nuk qëndron pasi për OE konkurrent që është për lot 1 i ka dorëzuar dokumentet e përshtatshmërisë dhe ka punuar platforma e-prokurim. Gjithashtu në bazë të Letrës standarde të dërguar nga KK Gjakova OE kanë pasur mundësinë ti dërgojnë edhe dokumentet kopje fizike në AK-KK Gjakovë, në bazë të të gjeturave si më lartë eksperti shqyrtues konstaton se pretendimi ankimor i OE ankues Profitech shpk nuk qëndron pra është i pa bazuar.

Përgjigje në pretendimin nr. 2

Sa i përket pretendimit 2 - eksperti shqyrtues mendon se ky pretendim është i pa bazuar duke u bazuar në nenin 65 të LPP-së. Pasi AK për të rekomanduar një kompani duhet ti kërkojë dokumentet

e përshtatshmërisë në këtë rast OE nuk i ka dorëzuar dokumentet e përshtatshmërisë në bazë të LPP-së neni 1. Operatori ekonomik nuk ka të drejtë që të marrë pjesë në një aktivitet të prokurimit ose të marrë pjesë në ekzekutimin e ndonjë kontrate publike, nëse operatori i tillë ekonomik, ndonjë punonjës, drejtues, menaxher ose drejtor i saj:

Po e citoj edhe RRUOPP: *Vërtetimet në lidhje me kërkesat e përshtatshmërisë (përveç Deklaratës nën Betim) do të kërkojnë të dorëzohen nga një tenderues të cilin autoriteti kontraktues ka për qëllim që ta shpërblejë me kontratë. Këto dokumente duhet të dorëzohen nga tenderuesi para publikimit të Njoftimit B58 mbi vendimin e AK-së. Afati kohor për dorëzimin e dokumentacionit të përmendur është jo më pak se pesë (5) ditë nga marrja e njoftimit të autoritetit kontraktues për synimin e dhënies së kontratës. Dështimi në dorëzim të dokumenteve të tilla, tenderi i tij do të refuzohet dhe AK do të vazhdojë me tenderuesin e listuar në vendin e dytë, si dhe do të konfiskohet sigurimi i tenderit nëse e njëjta është kërkuar dhe AK do të iniciojë procedurën për diskualifikim në përputhje me nenin 99.2 të LPP-së.*

Në bazë të fakteve që kemi në platformën e E-prokurimit, si dhe përgjigjet e cekura më lartë eksperti shqyrtues mendon se Ankesa e OE ankues Profitech shpk te cilësohet e pa bazuar dhe të mbetet në fuqi Njoftim mbi Vendimin e AK-së.

Mendimi i ekspertit shqyrtues

Eksperti shqyrtues propozon që Ankesa e OE të refuzohet si e pabazuar dhe të mbetet në fuqi vendimi i Autoritetit Kontraktues lidhur me aktivitetin e prokurimit.

Raporti i ekspertit shqyrtues është pranuar nga të dyja palët me ç'rast OE "Profitech shpk" nuk është pajtuar me raportin e ekspertit shqyrtues.

Duke u bazuar në nenin 24 par.1 të Rregullores së punës së OSHP-së nr.01./2020 Paneli Shqyrtues ka vlerësuar se në shkresat e kësaj lënde ka argumente dhe prova të mjaftueshme që vendimi meritor të merret edhe pa dëgjimin e palëve në seancë.

Paneli Shqyrtues duke i analizuar shkresat e kësaj lënde dhe veprimet e ndërmarra nga palët pohimet, konsideron se pretendimet e OE ankues janë të pabazuara, për shkak se OE ka pasur mundësi që sistemi me pasur probleme teknike me 08.09.2022, por jo deri më dt. 15.09.2022, dhe e mbështet arsyetimin e ekspertit sa i përket këtij pretendimi se konkurrentët tjerë për lote tjera i kanë sjellë dokumentet e kërkuara dhe nuk kanë pasur probleme.

Andaj, Autoriteti kontraktues ka vepruar konform Neni 1, Neni 6, Neni 7, Neni 59 të LPP-së.

Bazuar në të lartcekurat, Paneli shqyrtues vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi, në pajtim me nenin 117 të LPP.



Kryesues i Panelit Shqyrtues
Z. Vedat POTERQOI

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës Komerciale në Prishtinë, në afat prej 30 ditësh nga e pranimi të këtij vendimi.

Vendimi t'i dorëzohet:

- 1x1 AK –Komuna e Gjakovës;
- 1x1 OE- “Profitech shpk;
- 1x1 Arkivës së OSHP-së;
- 1x1 Për publikim në ueb- faqe të OSHP-së.